

Kur përdorni gjykatat, çdo institucion tjetër dhe policë të kapur nga prokuroria, po juaja, në përgjime zyrtare duke dhënë para me banditë e me kriminelë për të manipuluar çështje apo diskutime, nuk e keni për gjë të thoni: “Japim vërejtje”, ndërkohë që deputeti juaj vjen e turret për të ardhur në foltore, ndërkohë që jam duke folur. Pyetja ishte e thjeshtë, nuk e di pse të djeg kaq shumë: a janë zëvendëskryeministri dhe ministrja e Financave në përgjimet e prokurorisë italiane, apo jo? Kjo është pyetja? Nëse është një zëvendëskryeministër tjetër apo është personi parafolës që flet e bën si e Shenjta Mari, pa diskutim që kjo duhet parë; nëse është parafolësi ai që përflitet për para kesh dhe për përfshirje me të gjithë llumin e kimit nga laguna e Karavastasë në Divjakë dhe në Lushnjë dhe me të gjithë llumin tjetër, këtë jua provoj edhe te foltorja tjetër, si ta doni.

Meqenëse ishit duke folur për gjyqe dhe për gjykata, ja ku është zonja tjetër, e cila pak më përpara bëhej si e shqetësuar. Kam bërë akuzë se i është dhjetëfishuar pasuria. Ka shkuar në gjyq, po si ky zotëria. E ke humbur gjyqin. Ja cila është lidhja, për atë që folët pak më parë, pra jeni të gjithë të përfshirë, prandaj reagoni, prandaj doni ta largoni vëmendjen duke bërë zhurmë; prandaj doni të largoni vëmendjen nga qytetarët se ku shkojnë paratë e buxhetit të shtetit, paratë e drejtësisë sociale. Po çfarë drejtësie sociale?! Këtu i keni në medie, njerëz, deputetë të Partisë Socialiste, drejtues të qeverisë të cilëve veshja iu bën sa buxheti i 5 mijë familjeve që marrin ndihmë ekonomike në një vit. I keni të publikuara, ju që bëni më shumë të shqetësuarit, jo deputetë të tjerë, të cilët qëndrojnë në sallë. Me të drejtë mund të ketë deputetë edhe të nderuar, por ju që bëni reagimin më të madh, si më të shqetësuarit, flisni për buxhetin e drejtësisë sociale, kur në këtë vend çmimet janë trefishuar, taksat janë trefishuar dhe kanë shkuar pothuajse 300%, ku kostoja e jetesës për qytetarët ka shkuar në stratosferë. Ndërkohë, ju talleni se, kur taksat dhe çmimet rriten 300%, ju i rrisni 6% rrogat. Talleni e i thoni buxheti i drejtësisë sociale, se i ngarkoni bizneset, që nuk kanë mundësi, akoma më tepër me barrë, duke rritur pagën minimale, pa u dhënë asnjë ndihmë nga ana tjetër dhe duke i lënë tërësisht në punë të vet, pavarësisht pandemisë, pavarësisht krizave që kanë kaluar. Thoni se ky është buxheti më i madh. E vërteta është që ky buxhet është borxhi më i madh që u ngarkohet jo vetëm qytetarëve të sotëm, por edhe të nesërm, fëmijëve, edhe atyre që nuk kanë lindur në Republikën e Shqipërisë.

Një borxh, që ju e merrni dhe e çoni tek ata që dalin në përgjime, që ju marrin para apo sjellin para; tek ai tjetri që ju merr në Arbitrazh 120 milionë euro. E bëjmë temë ditë tjetër edhe se cilat janë lidhjet me deputetët këtu të kompanisë dhe të studios ligjore, që e mbështet apo që e mbron këtë personin, i cili i merr 120 milionë euro Shqipërisë. Çfarë bëni tjetër ju?! Po shkon tani për rishqyrtim plani urbanistik i Tiranës për të bërë kulla në mes të qytetit, për të prerë pyje dhe për të bërë vila. Drejtësi sociale në këtë vend, ku pothuajse 5 veta kontrollojnë 90% të pasurisë së shqiptarëve, të deklaruara, ose jo! Po flisni ju për drejtësi sociale, për Parti Socialiste dhe për parti të varfër, kur keni shkatërruar konkurrencën në biznes, duke futur paratë e pista të kimit, duke legjitimuar dhe duke u dhënë gjithçka me koncesion klientëve të qeverisë? Po për çfarë po flisni tjetër? “Pagesa për fëmijë”, thotë. Sipas Eurostatit janë larguar apo kanë kërkuar azil, se mund të jenë larguar shumë më shumë, jemi një vend që nuk kemi inventar se sa njerëz janë larguar nga Shqipëria, me kërkesë zyrtare te ministri i Brendshëm nuk e di sesa shqiptarë janë larguar... Eurostatit thotë se janë diku te 380 mijë kërkesa vetëm për azil ekonomik. Vetëm pas kësaj dhe pas kërkesave të bëra nga Partia Demokratike dhe opozita është futur një pagesë shtesë. Çfarë po ndodh sot në Shqipëri dhe çfarë nuk adreson ky buxhet? Ndërkohë, në Shqipëri ndodhin vrasje dhe krime të stilit mafioz, në mes të natës dhe në mes të ditës, në zonat më të populluara, në orët më të populluara. Të gjitha janë pa autor dhe gjenden

vetëm makinat në flakë, makinat e djegura. Nuk ka asnjë autor, policia shërben vetëm si agjenci telegrafike, agjenci lajmesh, ndërkohë që Shqipëria ka këtë gjendje të kriminalitetit, të niveleve më të larta të para ndonjëherë, me përfaqësues nga ana tjetër edhe në këtë sallë, të sponsorizuar, të nxitur (këta që bëjnë si më të pastrit, kryesisht)...Çfarë bëjnë Policia e Shtetit dhe qeveria? Çon para për të bërë tenderë në teknologji! Thotë: “Do të rriten pagat e atyre që punojnë jashtë”. E dini sa marrin sot policët e thjeshtë, oficerët apo punonjësit e Policisë së Shtetit? Rrinë pothuajse 8 orë më tepër në punë çdo ditë dhe, nga ana tjetër, u paguhen gjithsej 16 orë pune shtesë në muaj, pa asnjë pagesë për punën që kryejnë në shërbim të këtij vendi duke pasur kundër edhe drejtuesit e policisë, edhe drejtuesit politikë, duke pasur edhe krimin përballë. Flasin ne për buxhet tjetër në mbrojtje, ndërkohë që ushtarët dhe kontingjenti më elitar i ushtrisë stërviten ende në çadra. Ministria e Mbrojtjes bën 5,5 milionë euro muze, ndërkohë që nga hambarët e ushtrisë nuk ngrihet dot asnjë helikopter, e dinit këtë apo jo?! Nuk është ministri këtu. Asnjë helikopter nuk ngrihet dot. Kjo është fuqia e shtetit shqiptar sot. Një helikopter ka një vit e gjysmë që është rrëzuar në Itali dhe nuk e sjellim dot, se kaq është fuqia dhe buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes sot. Ka një vit e gjysmë që paguhet me taksat e shqiptarëve për parkimin, paguhet siguracion dhe nuk e sjellim dot. Kur bien zjarret, shkojnë atje policë e punonjës të nderuar të këtij vendi, ushtarë, punonjës të administratës publike me lopata përballë zjarrit. Qeveria e fut Agjencinë e Mbrojtjes Civile në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Përveçse gënjen shqiptarët për gjithçka, do të gënjejë edhe NATO-n për të rritur buxhetin dhe për t’iu afruar 2%-it, duke e rritur në mënyrë artificiale. Në të gjitha elementet ky buxhet nuk adreson asnjë prej shqetësimeve të qytetarëve. Shikoni pak se çfarë adreson në infrastrukturë. Ka 8 vjet rruga Qukës- Qafë Plloçë, e lënë gati, e tenderuar, e projektuar dhe as nuk dihet se çfarë bëhet. Ka 8 vjet qarku i Korçës që nuk ka asnjë investim në infrastrukturë. Nga rruga Qukës- Qafë Plloçë që duhej përfunduar; nga rruga Korçë-Pogradec që u bë në kohën e Partisë Demokratike; nga rruga Lin-Pogradec që u bë në kohën e Partisë Demokratike; nga rruga Pogradec- Korçë që u bë në kohën e Partisë Demokratike, në çdo rrugë që lidh rrugën nacionale me rrugët e fshatrave të bëra në kohën e Partisë Demokratike sot qeveria nuk ka asnjë investim, as në infrastrukturë, as në rend dhe siguri, as në bujqësi, as në çështjet sociale. Ka vetëm para që ndan me oligarkët, ka vetëm para që ia çon llumit, ka vetëm para që i bën me PPP-të. Faleminderit!